**VENDIM**
**Nr. 441, datë 20.5.2015**

# PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR.11, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2015, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 2041 veta ...".

2. Në lidhjen nr.1, bashkëlidhur vendimit, në ndarjet "(6) Ministria e Drejtësisë", "(7) Ministria e Financave", "(18) Institucione të tjera qeveritare" dhe "(20) Ministria e Zhvillimit Urban", shtohen nënndarjet, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

| Emri i Institucionit | Nr. Punonjës | Emërtesa | Koha ditore | Periudhë kohore |
|---|---|---|---|---|
| **( 6) Ministria e Drejtësisë** | **17** | | | |
| Drejtoria e Pergjithshme e Permbarimit | 1 | Ftues | 5 orë/ditë | vjetore |
| Drejtoria e Pergjithshme e Permbarimit | 1 | Mirembajtes | 5 orë/ditë | vjetore |
| Drejtoria e Pergjithshme e Permbarimit | 1 | Sanitar | 5 orë/ditë | vjetore |
| Drejtoria e Pergjithshme e Permbarimit | 1 | arkivist | 5 orë/ditë | vjetore |
| Instituti i Mjeksise Ligjore | 2 | ndihmes prozektor | 5 orë/ditë | vjetore |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare | 5 | Specialist | 8 orë/ditë | 3- mujore |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare | 4 | Operator | 8 orë/ditë | 3- mujore |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare | 1 | Korrektor | 8 orë/ditë | 3- mujore |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare | 1 | Korrier | 8 orë/ditë | 3- mujore |
| **(7) Ministria e Financave** | **502** | | | |
| Aparati i Ministrise | 2 | Specialist prokurimi | 8 orë / ditë | korrik dhjetor |
| Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve | 500 | Punonjes sherbimi | 4 orë / ditë | qershor- gusht |
| **(18) Institucione te tjera** | **1** | | | |
| Agjensia e Ofrimit te Sherbimeve Publike (ADISA) | 1 | Sanitar | 5 orë/ditë | vjetore |
| **(20) Ministria e Zhvillimit Urban** | **3** | | | |
| Agjensia Kombëtare e Planifikimit Territorit | 3 | Specialiste | 8 orë / ditë | 6- mujore |

KËRKESË

Shtetasi Njazi Golaj i biri i Ramizit dhe i Inxhijes, lindur në Mallkeq dhe banues në Vlorë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Sotir Golaj.

KËRKUESI

**Njazi Golaj**